



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D I M  
NR. 9 DATË 13.01.2009

PËR  
MIRATIMIN E STUDIMIT URBANISTIK PJESOR PËR "ZONË TREGTARE" ME  
SIPËRFAQE 18,6 HA, NË TERRITORIN BRENDA STUDIMIT URBANISTIK TË  
ZONËS NË PERËNDIM TË QYTETIT TË TIRANËS, MIRATUAR NGA KRRTRSH ME  
VENDIMIN NR.1 DATË 1.06.2006

Në mbështetje të neneve 7, 9 të Ligjit 8405 dt. 17.09.1998 "Për Urbanistikën", me ndryshimet përkatëse dhe Vendimit Nr.836 datë 03.12.2004 të Këshillit të Ministrave "Për përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar me VKM 717 dt 22.11.2005; me miratim të KRRT të Qarkut Tiranë me vendimin Nr.50 datë 15.10.2008;

duke marrë në konsideratë mendimin e Sekretarisë Teknike të KRRTRSH dhe diskutimet e antarëve të saj;

Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I :

1. Miratohet rishikimi i pjesshëm i studimit urbanistik të zonës në perëndim të qytetit të Tiranës (miratuar me Vendimin e KRRTRSH Nr.1 datë 1.06.2006), sipas planimeve bashkëlidhur.

2. Miratohet studimi urbanistik pjesor për "Zonë Tregtare" me sipërfaqe 18,6 ha, në territorin brenda studimit urbanistik të zonës në perëndim të qytetit të Tiranës, miratuar nga KRRTRSH me Vendimin Nr.1 datë 1.06.2006", sipas planimetrisë dhe rregullores bashkëlidhur.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Qarkut Tiranë dhe Komuna Kashar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

SALI BERISHA



PËR SEKRETARINË TEKNIKE TË KËSHILLIT TË RREGULLIMIT TË TERRITORIT  
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

KRYETARI




STAVRI RISTANI

SEKRETARI I KRRTRSH

MARIN BIÇOKU

MARIN-BIÇOKU



017  
51064



010